



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 72

Prishtinë, më 20.6.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj dhe Agim Ademaj.

**Munguan:** Selvije Halimi, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj Bujupi, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Liridona Xhemajli – RTV 21; Kosovare Muliqi – Rrokum TV; Hasan Hoti- Ekonomia Online; Valdete Daka dhe Enis Halimi- KQZ; Dibran Istrefi- Klan Kosova; Lumnije Murati- ZPRK; Lumturie Beka- Kosova.info; Drita Vitia- Kosova Press; Anita Avdyli- Praktikante; dhe Fjolla Uka- KDI.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të mbajtur më 24.5.2016 ;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të mbajtur më 24.5.2016**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes, të mbajtur më 24.5.2016, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2015;**

**Kryesuesja** ftoi kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve znj. Valdete Daka, për të marrë fjalën.

**Valdete Daka**, njoftoi anëtarët e Komisionit se viti 2015 nuk ishte vit zgjedhor, mirëpo, KQZ-ja, më 18.1.2015 organizoi zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Graçanicës, meqenëse kryetari i mëparshëm kishte dhënë dorëheqje. KQZ-ja i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara me ligj. Në këto zgjedhje, kanë qenë të certifikuara katër subjekte politike dhe katër kandidatë të këtyre subjekteve, për kryetar komune. Me qëllim të vëzhgimit të këtij procesi, KQZ-ja ka akredituar 392 vëzhgues dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet tjera, të cilat duhet të ndërmerren për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve.

Në këto zgjedhje, tha Daka, nuk kemi pasur votues jashtë Kosovës, edhe pse KQZ-ja ka aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet për aplikim. Megjithatë, kanë qenë tre votues që kanë votuar përmes ekipeve mobile, ndërsa të tjerët kanë qenë votues të rregullt. Po ashtu, theksoi ajo, vlen për t'u cekur se këto zgjedhje kanë kaluar pa incidente dhe nuk ka pasur raund të dytë, sepse që në raundin e parë është zgjedhur kryetari i Komunës së Graçanicës dhe çdo gjë ka kaluar qetë dhe pa probleme.

Gjatë planifikimit të strategjisë, KQZ-ja është përkrahur nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore ( IFES), me ekspertizë dhe mbështetje logjistike të tyre. Ky është një plan, i cili është një udhërrëfyes praktik për të gjitha organet e menaxhimit të zgjedhjeve për kryerjen e punës në tri vitet e ardhshme.

Znj. Daka theksoi se me mbështetjen e IFES-it dhe USAID-it, është formuar Grupi për Qasje në Zgjedhje, i cili gjatë punës ka pasur mision, që të sigurohet një barazi e plotë e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore, në jetën publike në përgjithësi. Ky grup përbëhet nga deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtarë të KQZ-së, përfaqësues nga PZAP-së, MPMS-së, MASHT-it, HANDIKOS-it, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve dhe Shoqata Down Syndrome Kosova. Ky grup ka mbajtur gjithsej 12 takime dhe si rezultat i punës është nënshkruar memorandum bashkëpunimi ndërmjet KQZ-së, Shoqatës HANDIKOS dhe shoqatave tjera me aftësi të kufizuara, ku KQZ-ja ka shprehur gatishmëri dhe përkushtim për angazhimin e këtyre personave në staf zgjedhor, gjatë proceseve zgjedhore. Po ashtu, KQZ-ja ka marrë pjesë në projektin e IFES-it, të mbështetur nga USAID-i, me qëllim avokimin për rritjen e numrit të femrave në staf zgjedhor dhe si rezultat është nënshkruar Deklarata e përbashkët e 17 subjekteve për rritjen e pjesëmarrjes së grave në staf zgjedhor për proceset e ardhshme zgjedhore.

Vlen të theksohet se në periudhën jashtëzgjedhore, KQZ-ja më tepër merret me rritjen e imazhit të saj, si dhe me angazhimin e stafit në trajnimin dhe përmirësimin e tyre, si staf zgjedhor.

Daka tha se 7 projekte që janë prezantuar dhe kanë gjetur mbështetje tek USAID-i dhe IFES-i, ndër to janë: Sistemi për menaxhimin e informatave të stafit zgjedhor; Platforma hartografike e digjitalizuar për informatat zgjedhore, të cilat janë në funksion të përmirësimit të procedurave zgjedhore.

Gjatë vitit 2015, KQZ-ja, ka pasur bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare. KQZ-ja është anëtare e A-WEB (Asociacioni i Trupave Zgjedhor Botëror), me të drejta të plota, së bashku me më shumë se 100 shtete të botës. Në fillim të këtij viti, KQZ-ja është bërë anëtare e Komitetit të Auditimit. Po ashtu, ka marrë pjesë në trajnime dhe seminare të mbajtura, si në vendin tonë, po ashtu edhe jashtë vendit dhe ka vëzhguar një numër të madh të zgjedhjeve. Pra, duke qenë pjesë e projekteve që i ka organizuar A-WEB-i, kemi vëzhguar zgjedhjet në Shqipëri, Poloni, Kirgistan etj.

KQZ-ja për vitin 2015, ka bërë regjistrimin e partive politike, ku është regjistruar një parti politike – Organizata Balli Kombëtar Demokratik, monitorimin e kuvendeve të partive politike, ku janë monitoruar 19 kuvende zgjedhore të partive politike, pezullimin e partive politike për mosmbajtjen e Kuvendit, ku janë pezulluar 12 sosh dhe ka çregjistruar 10 parti politike. Gjithashtu, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, ka organizuar trajnim me përfaqësuesit financiarë të subjekteve politike.

Ndërsa, si sfida të KQZ-së, të cilat ndikojnë negativisht në realizimin e aktiviteteve, Daka përmendi: mosintegrimin e sistemit unik të adresave në Regjistrin Qendror Civil, i cili ndikon në krijimin e listës votuese jo të saktë, objektet që shërbejnë si qendra të votimit, përgjithësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, mosauditimi i raporteve financiare të subjekteve politike, mostrajtimi i barabartë i stafit të Sekretariatit të KQZ-së, në raport me institucionet tjera të pavarura kushtetuese në paga, sepse kjo ndikon në cenimin e pavarësisë së institucionit dhe mosqëndrueshmërinë e stafit në institucion, mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë dhe aktivitet zgjedhore për stafin e KQZ-së, mungesa e mbështetjes së mjaftueshme në disa komuna për zyrtarët e lartë komunalë të zgjedhjeve, objekti të cilin KQZ-ja e shfrytëzon si Qendër e Numërimit dhe Rezultateve, është objekt i kontestit civil, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ekziston rreziku që në të ardhmen, ky objekt t’iu dorëzohet në pronësi personave tjerë.

Me qëllim të tejkalimit të sfidave dhe të vështirësive të lartpërmendura, në përpjekje për të ndërtuar një institucion profesional dhe të që qëndrueshëm të administrimit të zgjedhjeve, znj. Daka rekomandoi: integrimin e sistemit unik të adresave në Regjistrin Qendror Civil, të krijohet qasja në objektet që shërbejnë si qendra të votimit për personat me aftësi të kufizuara, të bëhet auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike, trajnim meritore i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe personelit të tij, që është i specializuar në fushën e organizimit të zgjedhjeve, sikurse institucionet tjera, të cilat kanë bazë të njëjtë kushtetuese, caktimi i një objekti të përhershëm dhe me hapësirë të mjaftueshme për punë për KQZ-në, ofrimi i mbështetjes nga disa komuna për zyrtarët komunalë të zgjedhjeve, futja në ligj e detyrimit për komunitat, në mënyrë që

t'i përkrahin KKZ-të, definimi i qartë i të drejtës së votës për votuesit dhe të përcaktohet vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, të regjistruar në Regjistrin Civil, dhe të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës, lehtësimi i mënyrës së votimit jashtë vendit, duke iu dhënë hapësirë më të madhe për pjesëmarrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, jashtë vendit, të gjenden mekanizmat për t'i identifikuar qytetarët e Republikës që jetojnë jashtë vendit dhe kanë të drejtë vote, si dhe shënimin e tyre në regjistër civil dhe në listën e votuesve, heqjen e votimit me kusht dhe angazhimi i institucioneve relevante shtetërore, për të përmirësuar të dhënat mbi qytetarët me të drejtë në regjistër civil, si bazë për krijimin e një liste të votuesve të saktë dhe të qëndrueshme dhe definimi i qartë i dokumenteve të identifikimit të votuesve gjatë procesit të votimit, duke caktuar vetëm dokumente shtetërore të Republikës së Kosovës, kuptohet, si dokumente të vlefshme për identifikim.

**Albulena Haxhiu, kryetare,** pasi mori fjalën, tha se do doja të ngrisja pesë shqetësime të punës njëvjeçare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. E para ka të bëjë me zgjedhjet në Komunën e Graçanicës dhe duhet potencohet fakti se në këto zgjedhje kanë votuar, votues me dokumente të Serbisë. Natyrisht se kjo është shkelje e rëndë e legjislacionit, por sidomos ndërhyrje e Serbisë dhe legjitimitimi që po i bëhet pranisë së saj edhe nga institucionet e Republikës së Kosovës. Ndonëse KQZ ka qenë e vetëdijshme që në Komunën e Graçanicës po votohet me dokumente të Serbisë, nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim për ti parandaluar këto votime. Gjithashtu në raport, si vështirësi është përmendur cilësia e listës së votuesve, qasja e votuesve në qendrat e votimit dhe votimi jashtë Kosovës, mirëpo, në brendësi të raportit shihet se pothuajse nuk është bërë asgjë për pastrimin e listës së votuesve dhe lehtësimit të mërgatës që të marrin pjesë në zgjedhje. Kosova, 30 % të popullsisë e ka jashtë vendit dhe janë vetëm 2000 votues që e shfrytëzojnë këtë të drejtë sepse për bindjen time mosshfrytëzimi i të drejtës së votës nga bashkatdhetarët është shumë problem serioz dhe sigurisht që duhet të rishikohen të gjitha procedurat burokratike dhe të gjendet mënyra që të shfrytëzohet ky potencial edhe për shkak të kontributit që bashkatdhetarët tanë ndër vite kanë dhënë për Kosovën. Tani së fundi kam qenë në tubime me bashkatdhetarë dhe ata kanë shprehur shqetësimin se procedurat janë tepër të vështira sa i përket votimit. Ka qenë një propozim i mirë që votimi të bëhet në Ambasada dhe Konsullata, por natyrisht që duhet edhe një rishikim të legjislacionit për këtë propozim. Më tutje pothuajse asnjë projekt nuk është realizuar gjatë vitit të kaluar edhe pse ka qenë një vit jozgjedhor, do të duhej të realizohej për shfrytëzimin e projekteve që e përmirësojnë administrimin e zgjedhjeve dhe sigurojnë integritetin e zgjedhjeve. Pjesa dominuese e raportit flet për vizitat jashtë vendit dhe vëzhgimin e zgjedhjeve nëpër vendet e caktuara, të cilat janë barrë e rëndë për taksapaguesit tanë, për shkak të buxhetit.

Haxhiu përmendi 2500 votues mbi moshën 100 vjeç, që janë evidentuar nga vetë KQZ-ja, dhe kjo shifër flet shumë për pasaktësinë e listës së votuesve ku dihet se në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mesatarja e personave mbi 100 vjeç, është 73 persona ndërsa në listë sipas KQZ-së janë 2500 persona. Ndërsa, numri i kutive të rinumëruara ka shkuar duke u rritur. Ka rritje të kutive të rinumëruara nga zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014 dhe mungojnë sqarimet se cilat janë arsyet e vërteta se pse po rinumërohen kutitë e votimit. Numri i kutive të rinumëruara flet për dyshimin e bazuar, që lidhen nga hapja e qëllimshme e kutive e

deri tek trajnimi i dobët i komisionarëve të cilët disa prej tyre nuk dinë edhe ti respektojnë procedurat për shkak të mostrajnitimit adekuat të tyre.

**Agim Aliu**, tha se e përkrah raportin e KQZ-së, përkundër faktit se nuk ka qenë një vit zgjedhor dhe si një vit i tillë që nuk ka pasur zgjedhje sigurisht që ka qenë më i lehtë dhe më me pak sfida. Unë mendoj, tha Aliu, se Komisioni Qendror Zgjedhor është dashur dhe do duhej që edhe pjesën e mbetur ta shfrytëzonte në mënyrë që të mënjanojë dobësitë e paraqitura gjatë proceseve zgjedhore. Edhe në këtë raport por edhe gjatë diskutimeve të kaluara të raportit të punës së KQZ-së, sikur na përsëriten disa nga vërejtjet që bëhen në procese të caktuara zgjedhore. E di faktin se as në të ardhmen nuk do të ketë sistem perfekt dhe nuk do ketë zgjedhje ideale, por gjithnjë duhet punuar që ato të jenë sa më të mira, ashtu siç ishin në vitin 2014, ku u pranuan nga të gjithë mekanizmat kombëtar dhe ndërkombëtarë. Në raportin që prezantuat jeni pjesë e vërejtjeve në formë të kërkesave dhe sfidave që i adresohen Komunave. Z. Aliu pyet se sa vizita keni bërë ju si KQZ në Komuna që të bashkërendoni aktivitetet e juaja së bashku me institucionet komunale zgjedhore dhe me institucionet komunale, në mënyrë që ato probleme të zgjidhen më drejtë dhe mirë.

Aliu tha se Komunitat mund të ndihmojnë në pastrimin e listave të votuesve, duke pasur parasysh se tashmë disa nga komunitat po mbulojnë shpenzimet për shërbimet mortore dhe ky shërbim është i kushtëzuar me sjelljen e certifikatës së vdekjes.

Shqetësim tjetër i z. Aliu ishte me votuesit që votojnë për herë të parë, të cilët regjistrohen vetëm me një Qendër Votimi sepse e vështirëson me një proces të ardhshëm zgjedhor mundësinë më të afërt për të votuar. Do duhej të kishte një agjendë nga KQZ-ja për ti vizituar Komunitat, në mënyrë që përveç atyre sfidave që keni paraqitur në raport të diskutohen edhe këto çështje që proceset e ardhshme zgjedhore ti presim sa më mirë.

**Armend Zemaj**, pyeti se a ka ndonjë plan të saktë apo një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, për hartimin e listës së saktë për zgjedhje dhe sidomos për Regjistrin Qendror Civil, pa anashkaluar edhe komunitat. Cili ka qenë angazhimi juaj konkret që të ketë auditim financiar të subjekteve politike, diçka që kërkohet vazhdimisht por që akoma nuk ka ndodhur përveç auditimeve dhe raportimeve që bëhet nga vetë subjektet politike, qoftë ato që marrin nga paratë publike apo nga donacionet dhe cili ka qenë roli juaj në zgjedhjet që ka mbajtur Serbia, sidomos në territorin e Kosovës dhe a keni pas mundësi vëzhgimi apo ndonjë lloj bashkëpunimi me këto trupa zgjedhore.

**Danush Ademi**, pyeti se a ka ndonjë mundësi që raportin final që e kanë kryesuesit nëpër Qendrat e Votimit, të nënshkruar nga të gjitha subjektet politike pas procesit të numërimit të votave, ta kenë nga një kopje të saj edhe partitë e vogla politike sepse po kemi problem ti kemi shënimet e sakta.

**Agim Ademaj**, tha se pajtohem me ato që thanë kolegët e mi por unë e kam shqetësimin tek disa komuna që nuk i kanë plotësuar kushtet KQZ-ve dhe në raport të përmenden me emra sepse

nëse bëhen emrat publik, është lehtë si Kuvend për të ndërmarrë ndonjë hap por edhe ato moralisht do ta ndjejnë veten që duhet të bëjnë hapa progresiv në këtë aspekt.

**Kryetarja**, theksoi se për mua dhe Vetëvendosjen ka qenë problem mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, por nuk duhet harruar faktin se nuk është përgjegjëse KQZ-ja për këtë pa dashur të amnistojë sepse nuk do ta bëja asnjëherë nëse do të isha përgjegjëse, por përgjegjësia kryesore për këtë i bie Kryeministrit Mustafa dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës sepse është dashur që të vihen në dispozicion të gjithë mekanizmat për të parandaluar zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, mirëpo, nuk ka pasur vullnet dhe as guxim për të parandaluar zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, për çka është cenuar sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës, ndërsa sa i përket auditimit të subjekteve politike, mendoj se është koha e fundit që duhet të auditohen për secilin cent që e marrin.

**Valdete Daka**, tha se sa i përket listës së votuese, duhet theksuar se KQZ-ja nuk mund ta ndërrojë listën votuese. Në momentit që merret lista votuese, ditën e dytë e të shpalljes së zgjedhjeve, KQZ-ja e merr ekstraktin ashtu si vjen nga Agjencia për Regjistrin Civil dhe ne nuk kemi mundësi ligjore të ndërrojmë asnjë emër përveç me vendim të Gjykatës, gjë që nuk ndodhur asnjëherë. Dhe, në periudhën jashtëzgjedhore KQZ-ja përsëri nuk ka mundësi ti largojë njerëzit. Ne kemi pasur vitet e fundit një grup punues, së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku ky grup punues ka larguar nga lista diku rreth 30.000 persona, ndërsa këtë vit ky grup punues nuk ka funksionuar, mirëpo, largimin e personave e bën Agjencia dhe jo KQZ-ja sepse nuk ka mundësi ti largojë personat e vdekur apo personat që e kanë hequr shtetësinë e Kosovës dhe që nuk duhet të jenë në listën e votuesve.

Bashkëpunim me Komunitet kemi, mirëpo, komunitet duhet të bashkëpunojnë me Agjencinë për Regjistrin Civil dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, duhet të bëjë presion tek komunitet përkatësisht gjendja civile që ata fillimisht ti largojnë personat që kanë vdekur. Ndërsa, ata persona që votojnë për herë të parë, ashtu si i marrin dokumentet, ashtu regjistrohen edhe për vendvotim, do të thotë nuk jemi ne që i caktojmë por në bazë të adresës që ata e japin i përcaktohet vend votimi dhe KQZ-ja nuk mund të t'ia ndërrojë vendvotimin pa kërkesën e tyre. Sa i përket zgjedhjeve në Graçanicë, edhe për dokumentet që kanë votuar qytetarët, KQZ-ja ka zbatuar vetëm Ligjin. Kurse, sa i përket auditimit, KQZ-ja këtë kompetencë nuk e ka sepse në ndryshimin e Ligjit të Financimit të Partive Politike, kjo kompetencë i është marrë KQZ-së dhe i është dhënë Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa për rolin e KQZ-së në zgjedhjet e Serbisë, Daka tha se KQZ-ja nuk ka pasur asnjë rol dhe nuk ka qenë fare e implikuar sepse ne organizojmë zgjedhjet në Republikën e Kosovës, ndërsa çështjet tjera janë çështje politike që ne si KQZ nuk merremi fare.

**Kryetarja** potencoi se është shqetësuese fakti se si deklaroheni që Ligji për zgjedhjet përmend vetëm dokumente valide, pa e saktësuar se cilat janë apo të cilat shtet janë ato dokumente valide. Neni 45 i Kushtetutës thotë “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës, që ka arritur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Kjo dispozitë Kushtetuese nuk

është zbatuar në komunën e Graçanicës apo edhe në komunat tjera me shumicë serbe dhe është absurde se zgjedhjet po organizohen në Republikën e Kosovës dhe votojnë persona që nuk kanë shtetësi të Kosovës, dhe kjo është shkelje e Kushtetutës.

**Enis Halimi** sqaroi për votuesit me moshë me mbi 100 vjeç, duke thënë se në këtë vit kemi marr përsipër që ti regjistrojmë njëpërnjë, ata përmes zyrtarëve tanë komunalë dhe në një mënyrë në mund ti konsiderojmë të hequr nga lista e votuesve personat që janë mbi 100 vjeç, të cilët kanë ndërruar jetë.

Sa i përket votimit jashtë Kosovës, në kemi tentuar, brenda rregullativës tonë ligjore ti ofrojmë mundësi qytetarëve tanë që janë në diasporë për të votuar. Është brengosëse fakti se në raport me numrin sa janë dhe sa votojnë është në disproporcion shumë të madh, por në sivjet, e që varet nga fondet, duhet të krijojmë një softuer që do të mundësojë regjistrimin e drejtpërdrejtë (online) të këtyre votuesve. Kutitë e rinumëruara janë indikator i syçeltësisë më të madhe në Qendër të numërimit të rezultateve dhe pa asnjë kompromis në mospërputhshmërinë më të vogël, që evidentohet në ato kuti, në mënyrë që të krijohet një proces i pranueshëm dhe përputhshëm të mirë të rezultateve.

*Pas diskutimeve, Komisioni vendosi me vota 5 për dhe 1 kundër (Albulena Haxhiu) që Kuvendit të i'a paraqes këtë :*

### **Rekomandim**

Të miratohet Raporti i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2015.

#### **4. Të ndryshme .**

Në pikën të ndryshme nuk pati diskutim

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**